

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	77/24
Nr. i fq. / Br. st	-8-
Ditë: / Datum	15.04.2024
VUSHTRRI - VUČITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN**

### **PROCESVERBAL**

**në mbledhja e III-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 mars 2024  
në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 10:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF-së).

Mungoi: Fakete Dushi.

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe Drejtoret e drejtive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoj Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e njajtueshme për punë.

Ajo tha se, si pikë shtesë për t'u futur në rend të ditës e kemi: "Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për varreza të kafshëve, në territorin e Komunës së Vushtrrisë".

**Hava Mlinaku, drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë (përfaqësuese e Kryetarit të komunës)** – kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës pika katër: "Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2023", pasi që nuk është hartuar kjo informatë, sepse drejtori ka qenë në pushim.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – tha se, nuk pajtohet që të hiqet nga rendi i ditës, sepse kuvendi e ka aprovuar planin e punës, të cilin duhet ta respektojmë. Pasi që, drejtoria përkatëse nuk ka arritur ta sjell në KPF, ka kohë që për kuvend ta përgatit, sepse kemi shumë pyetje që do t'i adresojmë lidhur me këtë çështje. Prandaj, i rekomandojmë drejtorisë që ta sjell në kuvend. Si ka mundësi që drejtori merr pushim, kur ka pikë të rendit të ditës për KPF e kuvend. Kjo është ikje totale nga përgjegjësia ose frikësim nga vetëperformanca dhe se Kryetari nuk është dashur t'i jep pushim drejtorit.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – deklaroi se, sa kam informacione, ai material nga drejtoria është përgatitur dhe është dorëzuar te zyra e kryetarit, por se pse nuk ka ardhur në KPF, nuk e di. I rekomandojmë drejtorisë që ta përgatit informatën për kuvend.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – lidhur me njoftimin për mospërfshirje në rend të ditës të raportit të NPL "Përparimi", çfarë arsyetimi është ky? Çka ka të bëjë auditori me reportin që NPL "Përparimi" duhet ta sjell në kuvend? Prandaj, kemi një arsyetim qesharak, përmes një e-maili, që herë shkruan në numrin njëjës e herë në numrin shumës.

Prandaj, unë kërkoj që raporti i NPL “Përparimi” të vjen në kuvend. Nëse ata janë aq transparent, më vonë le ta sjellin raportin e auditorit.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – ne kemi biseduar me kryesuesin e komisionit të aksionarëve dhe ai na ka njoftuar se deri në fund të marsit janë auditorët e jashtëm në ndërmarrje. Ai na tha se për muajin prill do të përgatitet raporti.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – pyeti se, si bëhet rendi i ditës pa material?

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – tha se, gjatë diskutimeve, na kanë premtuar se materialin do na e sjellin dhe kjo është arsyja.

**Komiteti për Politikë dhe Financa me pesë (5) vota “për”, asnë “kundër” e asnë “abstenim”, e futi në rend të ditës “Shqyrtimin e Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për varreza të kafshëve, në territorin e Komunës së Vushtrrisë”.**

**Komiteti për Politikë dhe Financa me tri (3) vota “për”, katër (4) “kundër” e asnë “abstenim”, rekomandoi që të mbetet në rend të ditës “Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë, për vitin 2023”.**

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

#### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.02.2024.
  2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko – financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2023.
  3. Shqyrtimi i Informatës përfundimin e gjysmëvjetorit të parë, të vitit shkollor 2023/2024.
  4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë. për vitin 2023.
  5. Shqyrtimi i Draft–Rregullores për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat.
  6. Shqyrtimi i Planit lokal të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, në Komunën e Vushtrrisë 2024 – 2026.
  7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për varreza të kafshëve, në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
  8. Pyetje dhe përgjigje.
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.02.2024.

**Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për”, aprovoi procesverbalin e datës 15.02.2024.**

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2023.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – deklaroi se, kjo është një prej pikave ku Kryetari i komunës është dashur të jetë i pranishëm. Sa i përket kësaj pike, ky raport është skandaloz dhe joprofesional. Titulli edhe për atë çka duhet të raportojë kryetari është shumë i qartë. Në brendi të këtij rapporti kemi përskrime të kota, e më së paku kemi përskrrim të saktë dhe konkret e konciz për zbatimin e planeve investuese. Kam përshtypjen që disa drejtore ende nuk i dinë kategoritë buxhetore, prandaj bëjnë raportime të tilla. Ky raport aspak nuk ka të bëjë me investime kapitale e as me planin e investimeve.

**Agron Perçuku**, anëtar i KPF-së – atë që e tha koleguështë realitet. Nuk ka shumë faj kryetari, sepse faji eshtë tek drejtorët e drejtorive. Eshtë për keqardhje se çka kanë dërguar drejtorët në këtë raport. Do ta procedojmë për kuvend, kurse në seancë do t'i paraqesim vërejtjet tona.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – tha se, ky nuk është raport për situatën ekonomike-financiare, por është një raport i punës, ku shumica janë bartur nga viti i kaluar. Po ashtu, është vështirë i lexueshëm tek tabelat e urbanizmit, lejet e ndërtimit. Prandaj, kërkoj që të përmirësohet për kuvend dhe të sjelljet një raport për situatën ekonomike-financiare.

**Hava Mlinaku, drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë (përfaqësuese e Kryetarit të komunës)** – tha se, përveç investimeve kapitale, ky raport është gjithpërfshirës dhe nuk është i koncentruar vetëm te investimet kapitale. Ne, për kuvend mund t'i bëjmë disa ndryshime, por raporti gjithmonë është sjell në këtë mënyrë.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – u shpreh se, raportet që vijnë nga drejtoritë janë raporte të drejtorive, e jo raporte nga Kryetari i komunës. Prandaj, ky është një raport që vjen direkt nga Zyra e Kryetarit dhe duhet të jenë të specifikuara shpenzimet e projekteve kapitale. Ndërsa, këtu nuk janë të paraqitura.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – sa po e shoh, këtu janë të paraqitura informatat e drejtive dhe vetëm janë shkurtuar paksa. Si informatat nga drejtoritë është në rregull, por si raport për situatën ekonomiko-financiare, s'ka të bëjë asgjë me këtë. Prandaj, si i tillë, ky raport është joprofesional.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet me raportin e investimeve kapitale dhe të procedohet për kuvend të komunës, në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – është mirë që të gjithë bashkë të angazhohemi që nxënësit të kenë më shumë dëshirë t'i vijojnë mësimet. Kjo për shkak se, nga informatat që na kanë ardhur vazhdimisht në kuvend, fëmijtë duke u rritur, suksesi i tyre në mësim bie, e ngrisin numrin e mungesave të paarsyeshme. Prandaj, është punë e prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve që të funksionojë më mirë trekëndëshi dhe gjendja të jetë më e mirë.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – te numri i nxënësve nëpër shkolla, te niveli zero, grupmosha 1-6 vjet (çerdhet) janë të përfshirë 1148 fëmijë. Mendoj se është dashur që të ndahen vetëm çerdhet dhe të raportohet për secilën çerdhe se sa është numri i fëmijëve dhe numri i edukatoreve. Sepse, “Foleja 1” ka fëmijë shumë pak, e edukatore shumë. “Foleja 2” ka fëmijë sa dyfishi i çerdhes “Foleja 1”, kurse janë nga dy edukatore. Njëjtë sikurse “Foleja 1” është situata edhe te “Foleja 3”, ka fëmijë më pak se “Foleja 2” dhe edukatore më shumë. Pra, tek “Foleja 1” dhe “Foleja 3” janë nga tri edukatore nëpër dhoma. Edhe në çerdhen “Foleja 2” ka fëmijë me nevoja të veçanta dhe ka nevojë për asistente. Pra, as nuk ka asistente e as mësuese mbështetëse. Vetëm disa asistente që prindërit i paguajnë me vetëfinancim. Prandaj, Drejtoria për Arsim duhet ta bëjë një balance nëpër çerdhe dhe mos të ketë kaq shumë diskrepancë mes edukatoreve dhe fëmijëve.

Është Udhëzimi Administrativ dhe Rregullorja e Ministrisë së Arsimit, që në bazë të numrit të fëmijëve të jetë edhe numri i edukatoreve.

**Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së** – mendoj që për kuvend duhet të plotësohet me një pasqyrë të numrit të nxënësve në 4-5 shkolla që janë më të rrezikuara aktualisht të mbyllen për shkak numrit të vogël të nxënësve. Nuk ka nevojë të jetë e mbyllur kjo temë, sepse do të ballafaqohemi me apo pa dëshirë me sfidën e mbylljes së këtyre shkollave për shkak të numrit të vogël të nxënësve në vitet e ardhshme. Pastaj, kjo do të jetë sfiduese që të sigurohen normat e orëve për ata mësimdhënës që punojnë në ato shkolla.

Kudo në Kosovë, kemi një diskrepancë të suksesit në mes të gjysmëvjetorit të parë dhe gjysmëvjetorit të dytë. Në gjysmëvjetorin e parë kemi një vlerësim më objektiv, kurse në gjysmëvjetorin e dytë bie kriteri dhe rritet kalueshmëria e nxënësve.

Drejtoria për Arsim duhet ta rris bashkëbisedimin edhe monitorimin me mësimdhënës dhe të shikohet se ku është problemi. Por, edhe t'i motivojë mësimdhënësit që të mbajnë kriter dhe ai kriter të jetë sa më real dhe objektiv. Sepse, edhe në aspektin e kurrikulave, falja e tillë e notave, gjegjësisht fryrja e suksesit nuk është në rregull.

Ajo që bie në sy është edhe dallimi shumë i madh në sukses në mes filloristëve dhe atyre në shkollat e mesme. Prandaj, si dukuri është mjaft shqetësuese edhe për prindërit, sepse në shkollë të mesme kur e kuption suksesin e fëmiut të tij që ka rënë, paraqet edhe një traumë për prindin.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – vlen të theksohet se ky gjysmëvjetor ka pasur edhe sfida për mësimdhënës/nxënës, ku ka pasur mungesë të librave në fillim të shtatorit. Përkundër këtij fakti dhe fakteve tjera që kanë qenë sfida, komunën tonë e kanë karakterizuar sukseset e mëdha në gara të ndryshme të diturisë dhe ato sportive. Prandaj, njihemi si komunë që edhe brenda vendit, por edhe jashtë vendit kemi shkëlqyer në këtë gjysmëvjetor. Angazhim duhet gjithmonë nga të gjithë, por jo vetëm i mësimdhënësve apo prindërve. Nëse të gjithë angazhohemi maksimalisht, edhe sukseset nuk do të mungojnë.

**Albanez Tahiraj, drejtor i Drejtorisë për Arsim** – lidhur me diskrepancën në mes të çerdheve që u ngrit si shqetësim, me parafolësen e kam diskutuar edhe personalisht. Kjo gjendje është e trashëguar nga e kaluara. Si drejtor, jam i ri në këtë drejtori dhe jemi duke e skanuar gjendjen. Disa asistente që kanë ardhur nëpërmes universitetit, kanë shprehur dëshirën që të punojnë në çerdhe private. Ne i kemi shprehur një notë proteste universitetit dhe organizatës nëpërmes së cilës ato janë sistemuar, pasi që në momentet e fundit e kanë bërë këtë veprim, duke treguar joseriozitet.

Sa i përket rrezikut të shuarjes së shkollave, kjo është kompetencë e ministrisë. Kur e kam marrë mandatin, i kam vizituar të gjitha shkollat. Kemi klasë me një nxënës, pastaj kemi klasë të kombinuara dhe aty vetëm cilësi të mësimit nuk mund të ketë. Mirëpo, kjo e tejkalon shqetësimin tonë, sepse mendësia aktuale kur është biseduar me komunitetin kanë thënë që nuk lejojmë mbylljen e shkollave, sepse ai fshat që nuk ka shkollë nuk është fshat. Ai tha se janë pesë paralele të ndara që janë shqetësuese edhe për neve, ku është një numër i vogël i nxënësve. Ne si drejtori u kemi krijuar kushte në mënyrë që mos të ketë mungesë të tyre për zhvillim të mësimit.

Ministria e ka kompetencë ekskluzive që me një vendim mund t'i mbyll shkollat, ashtu siç është kompetente për themelim të tyre. Prandaj, nëse bëhet shuarja apo bashkimi i shkollave nga ministria, duhet që ata mësimdhënës të sistemohen në shkollat tjera.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – drejtor, e çmoj dhe e vlerësoj punën tënde, edhe e kam parasysh që je i ri në këtë drejtori. Mirëpo, edukimi në fëmijërinë e hershme është shumë i rëndësishëm në edukimin e fëmijëve në vazhdimësi. Dua të të njoftojë, se jo vetëm asistentet që kanë ardhur nga universiteti, por në dy konkursen e fundit që janë pranuar edukatoret, asnjë edukatore nuk ka ardhur te “Foleja 2”, por kanë shkuar në çerdhet “Foleja 1” dhe “Foleja 3”. Në çerdhen “Foleja 3” i kanë nga 18 fëmijë nëpër dhoma dhe janë nga 3 edukatore. Në çerdhen “Foleja 2” i kanë nga 28 fëmijë nëpër dhoma dhe janë nga 2 edukatore. Nuk kam asgjë kundër askujt, por duhet të bëhet një balancim nëpër çerdhe. Sepse, në këtë formë qysh është duke funksionuar, mungon edhe cilësia.

**Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së** – lidhur me çështjen e shkollave që mbisin pa nxënës, nuk është kompetencë e Ministrisë së Arsimit. Është rasti i Kamenicës, të cilin kontest ministria e ka humbur në raport me komunën. Për shkak se arsimi parauniversitar dhe kujdesi parësor shëndetësor është kompetencë vetanake e komunave. E dimë që kjo çështje është shumë sfiduese, por herët a vonë do të ballafaqohemi me këtë. Ndoshta, do të ishte mirë që drejtoria për vitin e ardhshëm ta fus si projekt që të bëhet një fizibilitet nga një organizatë profesionale, ku do të bëhet matja se me çfarë kosto ekonomike, financiare dhe cilësore do t'i kushtojë mbajtja e këtyre shkollave, pra a ja vlen apo jo.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – drejtori tha se gjendjen në terren jemi duke e skanuar. Këtë e kemi dëgjuar edhe nga parardhësit tuaj. Zyrtarët e drejtorisë është dashur ta kenë të skanuar gjendjen, sepse secili është përgjegjës për sektorin e vet. Çka do t'iu thoni qytetarëve në fund të mandatit se çfarë keni bërë për arsimin.

**Albanez Tahiraj, drejtor i Drejtorisë për Arsim** – skanimi i gjendjes është proces i vazhdueshëm. Ne e kemi bërë një plan special kundër braktisjes, prandaj ky është një skanim. Prandaj, komuna jonë, sa i përket organizimit të punës dhe angazhimit është model për komunat tjera. Përkushtimi i stafit të drejtorisë është i jashtëzakonshëm.

Sfida janë edhe kërkesat e mësimdhënësve për pushim pa pagesë, pas liberalizimit të vizave.

**Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë, për vitin 2023.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se, shqyrtimi i kësaj pike për mua është absurde, sepse nuk kemi material dhe se diskutimet veç i përfunduat për rendin e ditës.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se, për neve është absurde pse është pikë e rendit të ditës pa material.

**Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së** – deklaroi se, informata që vjen në kuvend t'i përmbajë edhe këto çështje: Çka ka bërë Drejtoria për Inspektore gjatë vitit 2023?

Gjatë tri viteve nuk kam parë që kanë rrënuar objekte pa leje.

Ai kërkoi që të sjellë leja dhe kriteret e ndërtimit të ndërtuesës përballe Postës? Nuk jam ekspert i kësaj fushe, por kam dëgjuar që duhet të ketë distancë në mes të objekteve. Kurse, në këtë rast, nga ballkoni i njërit objekt mund të kalosh në ballkonin e objektit tjeter.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – kërkoi raport nga Drejtoria për Inspektore (Sektori i ndërtimit) lidhur me objektin që është duke u ndërtuar përballe Postës dhe për objektin përballe Urës së Gurit në Vushtrri.

**Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me katër (4) “për”, tri (3) “kundër”, i rekomandoi Drejtorisë për Inspektore që me këto sugjerime ta sjell për kuvend informatën.**

5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat.

**Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së** – sa e di, ka pasur një rregulllore për këtë çështje, prandaj kisha kërkuar sqarime se cilat janë arsyet që duhet të ndërrohet. Nga ajo që e pashë në këtë draft, nuk pashë që ka një rregullim të ndarjeve meritore të subvencioneve. Në asnjë pikë nuk është caktuar forma e përzgjedhjes dhe vlerësimi. Prandaj, kriteret është dashur që të përcaktohen me këtë rregulllore dhe të bëhet një kategorizim.

**Ergin Sunguri, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** – deklaroi se, kur të formohet komisioni, ata i përcaktojnë kriteret për ndarjen e subvencioneve. Qëllimi i kësaj rregulllore është lehtësimi i procedurave të fermerëve për të përfituar subvencione.

**Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së** – theksoi se kriteret nuk mund të caktohen nga komisioni.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së** – kërkoi që në kuvend të jetë i pranishëm kryesuesi i komisionit për hartimin e kësaj draft-rregulloreje.

**Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) “për”, dy (2) “kundër”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

6. Shqyrtimi i Planit lokal të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë 2024 – 2026.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – kërkoi që deri në seancë të na njoftojnë se: Sa është numri i banorëve nga komuniteti rom dhe ashkali në Komunën e Vushtrrisë?

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet përvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për varreza të kafshëve, në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet përvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

8. Pyetje dhe përgjigje.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – meqenëse në mbledhjet e kaluara të kuvendit kemi pasur disa paqartësi rreth çështjes së votimit, ku ka qenë proces diskutabil dhe i është dërguar MAPL-së. A mund të na informoni kryesuese, se çfarë përgjigje ta kanë kthyer MAPL-ja?

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – e kemi marrë përgjigjen nga MAPL-ja dhe ka mbetur në kompetencën tonë me vepru dhe me konstatu. Jam duke bashkëpunuar me Zyrën Ligjore dhe besoj që në mbledhjen e kuvendit do ta kemi një veprim.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – ai tha se, ka komunikuar me disa zyrtarë të MAPL-së, lidhur me këtë çështje, ku ju si zyre e kuvendit keni dalë qesharak, për shkak se ju keni kërkuar sqarim se cili propozim ka kaluar. Ata thanë që kuvendi i komunës duhet ta nxjerr vendimin e ta dërgoj për vlerësim, e jo ne t'ju tregojmë se cili propozim ka kaluar.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se, bashkëpunimi i kuvendit me MAPL-në është përtej vendimeve, jo vetëm përvlerësim të vendimeve. Për dikë mund të jetë qesharake, por unë shumë sinqerisht ju kam drejtuar MAPL-së (nuk është hera e parë, sepse ju kam drejtuar edhe për çështje tjera) dhe i falënderoj për bashkëpunimin që kemi. Qëllimi im është shumë i sinqertë dhe barrën më të madhe ndaj zyrtarëve e ndjej unë. Mirëpo, atë ditë, sipas mendimit tim ka qenë votim i parregullt, për shkak se ka pasur anëtarë të kuvendit që kanë votuar përvend dyja propozimet. Prandaj, jam duke punuar intensivisht që deri në seancën e kuvendit të merr një rrugë kjo çështje.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – tha se, Zyra Ligjore e komunës nuk ka më asnjë kompetencë lidhur me atë se çka kemi votuar ne. Është në dorën tende si kryesuese, ose ta sjellësh edhe një herë në kuvend ose ta konstatosh si të plotfuqishëm njërin vendim (qoftë përv 3 euro apo 4 euro).

**Fatmire Cecelia, anëtar e KPF-së** – tha se, në rrugën “Ismail Qemajli” është rrënuar një objekt, ku kanë filluar punimet për ndërtimin e një objekti banesor. Nëse operatori posedon lejen e ndërtimit, atëherë kërkoj që të ma sillni deri në mbledhjen e kuvendit.

**Mentor Hasani, anëtar i KPF-së** – është e vërtetë që është bërë e madhe çështja e shujtave. Nëse i duam aq shumë zyrtarët, është dashur që ta aprovojmë propozimin me 3 euro, e pastaj më vonë nëse vlerësohet që kjo shumë financiare nuk mjafton, atëherë të vjen propozimi në kuvend për rritje të vlerës financiare në bazë të buxhetit. Me këtë veprim janë goditur zyrtarët që e kanë pritur këtë shujtë. Me dashje apo padashje, opozita i ka dëmtuar shumë zyrtarët. Edhe unë pajtohem që në seancën e ardhshme të procedohet me shumën fillestare, ashtu si ka qenë, prej 3 euro, e mos të bëjmë veprime populiste.

**Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së** – u shpreh se, opozita ka qenë shumë e sinqertë që t'i përkrah zyrtarët, por ishte një anëtar i kuvendit, që është në koalicion me pozitën, ai që propozoi vlerën financiare prej 4 euro. Prandaj, ne si LVV i mbështesim politikat e majta socialdemokrate që e përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve. Ne e kemi mbështetur një propozim që ka ardhur nga ju si pushtet në këtë rast.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – nuk kisha dashur të hyjë nëakuza as për pozitën e as për opozitën, por kisha kërkuar që ti si kryesuese jepi rrugë kësaj çështjeje dhe se në kuvend nuk ka nevojë ta sjellësh, por vetëm na informon se çka ke vepruar.

Mbledhja përfundoi në orën **11:40**.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi

Kryesuese e KK-së dhe KPF-së

